

VENDIM
Nr. 142, datë 25.6.2018

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 8, DATË 4.2.2009, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 16; 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 3.5.2, pikës 3.5.4, germa “a”, pikës 3.7.1 dhe pikës 4.4, pikës 5.1, germa “b”, të “Kushteve licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, me nr. 75, seria T09P, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shfuqizimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., me nr. 75, seria T09P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 4.2.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Subjekti “Enpower Albania” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 4.2.2009, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe është mbajtës i licencës me nr. 75, seria T09P.

- Vendimi i sipërcituar është ndryshuar më pas me atë me nr. 10, datë 20.2.2009, i cili ka ndryshuar afatin e vlefshmërisë së kësaj licence nga 5 vjet në 30 vjet.

- Subjekti ka shkelur kushtet e licencës së dhënë nga ERE, si më poshtë:

- nga të dhënat e përditësuara të marra nga Drejtoria e Administrim-Financës lidhur me pagesat e rregullimit, për llogari të ERE-s, nga subjekti nuk është bërë pagesa e rregullimit, për periudhën viti 2012–2018, në kundërshtim me pikën 3.7.1 të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, ku përcaktohet, se i licencuari është i detyruar të paguajë në ERE pagesën e licencës ose pagesa të tjera të aplikueshme, sipas nenit 12, të ligjit të nr. 9072, datë 22.5.2002, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe shprehur në këtë të fundit në nenin 17, për pagesat e rregullimit;

- referuar pikës 3.5.2 të licencës, të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe të paraqesë në ERE më 31 janar të çdo viti një raport vjetor, lidhur me operimet e tij, gjatë vitit të mëparshëm kalendarik. Nga verifikimet e bëra për këtë qëllim nuk rezulton të ketë depozituar një akt të tillë në ERE, në kundërshtim për sa referuar në pikën 3.6.2 të licencës;

- subjekti ka ndryshuar selinë pa njoftuar ERE-n, në kundërshtim me pikën 3.5.4, germa “a” (detyrime të licencuarit për adresën) të licencës, në referim të së cilës i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim;

- referuar pikës 4.4 të licencës, kur ERE konkludon se i licencuari nuk ka respektuar kushtet e licencës, ERE mund të rishikojë vlefshmërinë e licencës;

- sa pasqyrohet më sipër, licenca e tregtimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. e ka humbur legjitimitetin e saj, për shkak të shkeljes së kushteve të sanksionuara në vetë licencën dhe kuadrin ligjor që vepron në sektorin e energjisë elektrike;

- bordi i ERE-s, me vendimin nr. 141, datë 25.6.2018, ka vendosur, “Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 16.9.2008, për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., me nr. 65, seria NPM08P, në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 8, datë 4.2.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

2. Licenca me nr. 75, seria T09P, e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti